



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK

Procesverbal i degjeses publike “ Per dhenien ne perdorim te siperfaqeve pyjore per prodhimin e energjise se rinovueshme fotovoltaike”

Data : 05/11/2025 **Ora :** 11:00

Vendi: Fshati Korthpule

Numri i pjesëmarrësve : 18 , 16 burra dhe 2 gra

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : “ Per dhenien ne perdorim te siperfaqeve pyjore per prodhimin e energjise se rinovueshme fotovoltaike”

Takimi drejtohet nga Z. Ferit Ringaj **Zv.Kryetari i Bashkise i cili bëri një prezantim të shkurtër në lidhje me :**

- ✦ Projekt-aktin e propozuar dhe realcionin shoqërues
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete që ka për pjesëmarrësit

Ne vijim e mori fjalen Angjelin Dodaj, drejtori i sherbimit pyjor ne Bashki, i cili beri nje prezantim te shkurter te studimit te kryer nga sektori pyjor te siperfaqeve te tokave inproduktive te zones se Korthpules , ku jane rreth 37 ha te studjuara , qe mund te jepen ne perdorim per te plotesuar kerkesat e te interesuareve per prodhimin e energjise se rinovueshme. Nje nder personat e interesuar dhe qe ka bere kerkese per nje siperfaqe rreth 11.5 ha eshte Gjovalin Gjoni dhe se bashku me ing. E subjektit te tij eshte prezent nedejese dhe do te shpjegoje disa nga avantazhet qe i krijon zones veprimtaria e tij.

Ing. Enerjoni beri disa sqarime teknike ne lidhje me vendosjen e paneleve diellore. Siperfaqja mund te perdoret per kullota. Gjate periudhes dyvjecare eshte e mundur te punesohen rreth 150 persona, ndersa ne kohen tjeter 5 persona. Do te ndihmohet zona

me riparime te rrugeve, do te mbeshteten student nga zona me bursa per te kryer studimet dhe per t'u punesuar ne objekt. Toka nuk eshte e shfrytëzuar dhe nuk i bejme asnje dem familjeve.

Ferit Ringaj: Ne emer te Bashkise ju pershendes dhe ju falenderoj , qe jeni prezent ne kete degjese. Bashkia po bene perpjekje maksimale per zhvillimin e zonave me pak mundesi. Kompanite , qe investojne kane detyrime per taksa per Bashkine dhe per te ndihmuar ju , duke mirembajte rruget, duke punesuar banore te zones dhe duke mbeshtet familjet ne nevojë. Mendoj se duhet te jepni mendimet tuaja ne lidhje me mundesite dhe nevojat e ketij fshati.

Gjovalin Herceku: kryetari i fshatit korthpule. Duhet me pa zonen kokretisht, sepse kena kullatat e bagetive. Kena lope, i percjellim ne mal , lopa nuk mund te kullot , sepse firma mund te beje rrethimin e territorit.

Gjovalin Gjoni : I nteresuar per vendosjen e paneleve. Njerezit jane pak cinik, une kam punu ne zonen e Gjadrit, ne fillim hezitonin, nxirrnin pengesa kot fare, por tani qe kane provuar benefitet jane te kenaqur. Ne Shqiperi sipas vendimit te qeverise eshte e mundur te vendosen vetem ne toka inproduktive.

Gjovalin Herceku: Theksoj se ne kete zone nuk u mbollen pisha ne kohen e diktatures, sepse kjo zone u la per kullota. Kjo zone ka qene rezervuar per blegtorine.

A ka pasoja per shendetin vendosja e paneleve diellor?

Ing. Enerjoni shpjegoi se nuk ka asnje dem shendetesor, sepse panelet jane prej xhami.

Gjovalin Herceku : A mund te ndihmohet fshati jone , psh, duke na dhene nga nje panel? Ne ne dimer nuk kemi furnizim te rregullt me energji, prandaj kerkojme mbeshtetjen tuaj.

Ing. Enerjoni Ajo qe mund te bejme, ne do te ndihmojme familjet ne nevojë duke ju paguar faturat e energjise, sepse ne nuk furnizojme me energji askend.

Gjon Suta: Cfare na ndihmojne ne ? A na demtojne?

Age Suta : Kerkojme te na ndihmojne per pastrimin e rruges se sa here ka stuhi, rruga behet e pakalueshme.



Ing. Enerjoni : Per te demtuar nuk demtojme asgje, per te ndihmuar do te bejme cdo gje qe eshte e mundur.

Gjin Perndreu: Keroj te na ndihmojne me asfaltu rrugen.

Ferit Rringaj: Bashkia ka bere projekte dhe do te perpiqemi , qe t'i zbatojme ato, duke gjetur burime financimi, kemi shume veshtersi, sepse numri i banoreve eshte i kufizuar dhe cdo investim kerkon te justifikohet se sa njerezve u sherben.

Gjovalin Gjoni: Duhet te dini se Korthpula do te perfshihet nga nje program i madh qeveritar ne zonen e bjeshkes dhe nga ky program do te jete perfitues fshati juaj.

Ferit Rringaj: Ju falenderoj per pjesemarrjen dhe per probleme qe prezantuat. Bashkia do te jete e hapur gjithmone per te bashkepunuar me ju dhe per t'ju ndihmuar.



Sekretari i Këshillit

Hazbi Terbuni

Handwritten signature of Hazbi Terbuni in blue ink.

Lista e pjesemarrësve ne konsultimin me publikun : date 05.11 .2025

Degjesa publike ne Korthpule

Nr	Emri Mbiemri	Institucioni	Nr. kontaktit	Firma	Verejtje
1	yjon Luta				
2					
3	Age Luta				
4					
5	Enver Bekar				
6					
7	Nolce	Rektor			
8	Gjin Perndreu				
9	Emiliano Herceku				
10	Gjovani Herceku				
11	Nolce Frrok				
12	Vilson Herceku				
13	Rodion Perndreu				
14	FERIT RINGAJ	Bashkia e Rrethit 068634171			
15	Angelina Lodej	Dr. Gj. Gj. 0682290673			
16	Hazbi Terishi	Sek. Kom. 0672659438			
17	Enver Gjoni	0634291582			
18	Gjovani Gjoni				
19					
20					
21					
22					
23					
24					
25					
26					
27					
28					
29					
30					
31					
32					
33					
34					
35					
36					
37					
38					
39					
40					